



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr-400-36774

Me date 08.07.2024

Kryetari i Komunës së Suharekës në mbështetje të nenit 13 dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenin 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, e konform nenit 4, paragrafi 1, pika 1.8, lidhur me nenin 20, paragrafi 3, të Ligjit Nr-06/L-021, për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.3/2018" e në zbatim të nenit 4, lidhur me nenin 6, të Udhëzimit Administrativë MF-Nr. 01/2019, për Themelimin dhe Funkcionimin e Komitetit të Auditimit në Sektorin Publik, nxjerrë këtë:

**V E N D I M**

Për themelimin e komitetit për auditimin e brendshëm

1. Themelohet komiteti i auditimit të brendshëm për Komunën e Suharekës, në këtë përbërje:
  - 1.1 Agron HOXHA-----kryesues
  - 1.2 Marigona REXHEPAJ-ELSHANI-----anëtare
  - 1.3 Shpresim KUÇI -----anëtar
2. Komiteti i auditimit të brendshëm në Komunën e Suharekës, mban takime të rregullta (së paku një herë në tre muaj) ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin e zbatueshëm për auditim dhe i raporton Udhëheqësit më të lart administrativ për rezultatet e takimeve.
3. Detyrat dhe përgjegjësit e komitetit të auditimit të brendshëm janë të përcaktuara me Ligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike të Republikës së Kosovës dhe aktet tjera nënligjore për zbatimin e këtij ligji të nxjerra në pajtim me praktikat dhe standardet ndërkombëtare të auditimit.
4. Kryesuesi dhe anëtarët e komitetit të auditimit të brendshëm për takimet e mbajtura paguhet ose kompensohen në pajtim me nenin 5, të Rregullores Nr.34/2012, për pagesën e pagave dhe shtesave të Kryetarëve/Kryesuesve dhe anëtarëve të bordit për rishqyrtimin e ankesave, komiteteve të auditimit, këshillit Kosovar për raportim Financiar.
5. Mandati i komitetit të auditimit të brendshëm është 3, (tre) vjeçar, me të drejtë riemërimi edhe për një mandate të dytë.
6. Ky vendim hynë fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Suharekës.

**Të njoftohen;**

Njësia e auditimit  
Anëtarët e Komitetit  
Evidenca

